



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	11.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTHEK	7414/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1279/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1279/2023, të datës 12.10.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson avokat [redacted] kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1279/2023, e datës 12.10.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 08/27-967-2023, i datës 18.09.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Vendimi me numër protokolli 02/799-2023, i datës 17.08.2023, i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 02/799-2023, i datës 07.07.2023, i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankueses t'i bëjë kompensimin e ditëve të pushimit të pushimit vjetor për vitin 2022 dhe 2023, ashtu siç është përcaktuara me Vendimin me numër protokolli 02/799-2023, të datës 07.07.2023 dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [] tani e pensionuar, më datë 12.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 08/27-967-2023, të datës 18.09.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Vendimit me numër protokolli 02/799/A-2023 të datës 17.08.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të : shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje KPMSHCK*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa, ky i fundit, me datë 18.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesës si dhe provat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6522/2023 të datës 12.10.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 10.10.2023 për përfaqësim të ankuses; Vendimin me numër protokolli 08/27-967-2023 të datës 18.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Vendimin me numër protokolli 02/799/A-2023 të datës 17.08.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Vendimin me numër protokolli 02/799/2023 të datës 07.07.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Ankesën e datës 23.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Konteste dhe Ankesa; Emailin e datës 29.07.2022 nga ankuesja për Kërkesë për pushim vjetor e datës 29.07.2022 dhe 03.11.2022; Emailin e datës 26.08.2022, 24.08.2022, dhe 10.08.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 08.08.2022 dhe 04.08.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 01.09.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 01.09.2022 nga për ankuesen; Vendimin me numër protokolli 01/1369-2022 të datës 15.11.2022; Vendimin me numër protokolli 02/1390-2022 të datës 17.11.2022; Vendimin me numër protokolli 01-253-2023 të datës 09.03.2023; Vendimin me numër protokolli 02-236-2023 të datës 06.03.2023; Kërkesën për kompensimin e pagesës për pushim vjetor të pashfrytëzuara e datës 09.06.2023 e ankuses për Kryeshefin Ekzekutiv të SKQZ-së; Emailin e datë 18.09.2022 dhe 03.11.2022, nga ankuesja për Vendimin me numër protokolli 423-2022 të datës 11.03.2022; Vendimin me numër protokolli 3545-2021 i datës 29.12.2021; Kërkesë për pagesën retroaktive 01.03.2022; Vendim A.nr.434/2022 të datës 27.06.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 02-120-2023 të datës 06.02.2023; Vendimin me numër protokolli 02-184-2023 të datës 20.02.2023; Vendimin me numër protokolli 02-245-2023 të datës 08.03.2023; Vendimin me numër protokolli 02-283-2023 të datës 10.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 18.10.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 04.02.2019; Vendimin me numër protokolli 02/707-2023 të darës 05.06.2023; Vendimin e datës 21.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e parashtruar nga palët në procedurë, konstatoi së janë të bazuar pretendimet ankimore të ankueses sepse:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja ka qenë e punësuar në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 67-4-2019 të datës 04.02.2019, ka ushtruar pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Përkrahjes*. Me vendimin me numër protokollit 02/707-2023 të datës 05.06.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (me tej SKQZ), ankueses i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit nga data 21.06.2023. Tutje, ankuesja më datë 09.06.2023, ka parashtruar të organi i punësimit kërkesë për kompensimin me pagesë për pushim vjetor të pa shfrytëzuar për vitin 2022 dhe 2023.

Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së, fillimisht me Vendimin me numër protokollit 02/799-2023, të datë 07.07.2023, ka miratuar kërkesën e ankueses të datës 21.06.2023 për kompensim të pushimit vjetor dhe atë 38 ditë për vitin 2022 dhe 29 ditë për vitin 2023, kurse me Vendimin me numër protokollit 02/799/A-2023 të datës 17.08.2023, ka shfuqizuar Vendimin me numër protokollit 02/799-2023 të datës 07.07.2023, me arsyetimin se neni 6 paragrafi 8 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për Pushimet e Stafit të SKQZ i referohet rasteve të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në institucion, ndërsa, tek rasti i ankueses kemi të bëjmë me përfundim të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesja kundër Vendimit me numër protokollit 02/799/A-2023 të datës 17.08.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa, ky i fundit me Vendimin me numër protokollit 08/27-967-2023, të datës 18.09.2023, ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar me ankesë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ka kundërshtuar Vendimin me numër protokollit 08/27-967-2023 të datës 18.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe Vendimin me numër protokollit 02/799/A-2023 të datës 17.08.2023, pretendon se vendimet e kundërshtuara janë në kundërshtim me bazën juridike, gjendjen faktike dhe provat e lëndës; Tutje shton se në rastin e ankueses është vepruar në kundërshtim me rastet paraprake në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ngase nëpunësit i është bërë kompensimi i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor dhe kjo është vendosur edhe me Vendimin A.nr.434/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. E drejta e kompensimit të pushimit vjetor të pashfrytëzuar siç është rast im njihet edhe sipas Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës sepse pushimi vjetor është e drejtë e garantuar sepse ose i njëjti duhet të shfrytëzohet ose në pamundësi të shfrytëzimit të bëhet kompensimi; Andaj, edhe referimi i vendimeve të kundërshtuar se kompensimi nuk lejohet për shkak që nuk kemi të bëjë me ndërprerje të marrëdhënies së punës por me përfundim për shkak të arritjes së moshës së pensionimit është në kundërshtim me nenin 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj vendimet e kundërshtuara me ankesë dhe të obligoj ZKQZ-së, që ankuese ti bëjë kompensimin në

mjete monetare të pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2022 dhe 2023 dhe atë 38 ditë për vitin 2022 dhe 29 ditë për vitin 2023.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, fillimisht ju referua Aktgjykimit në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të datës 09.07.2020 me Nr.ref.:AGJ 1583/20, ku në dispozitivin e këtij aktgjykimi është caktuar se: *II. TË KONSTATOJË që nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafët 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41 (paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri me: nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]; 109 [Prokurori i Shtetit]; 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]; 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; dhe me nenet 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës; III. TË KONSTATOJË që Ligji nr. 06/L-U4 për Zyrtarët Publike nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetute*

Duke marr parasysh aktgjykimin si me lart, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së përfundimi i marrëdhënies së punës së ankueses për arsye të arritjes së moshës së pensionimit, është bërë mbi bazën e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë dhe aktit të brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjegjësisht Udhëzimit Administrativ Nr.01/2018 për Pushimet e Stafit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë kontekst, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që rregullojnë përfundimin dhe marrëdhënien e punës në shërbimin civil, përkatesisht:

Nenit 39: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pushim vjetor dhe në pushim për festa zyrtare në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi. 2. Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë me kohëzgjatje minimale prej tetëmbëdhjetë (18) ditë pune, në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësimit. 14 3. Kohëzgjatja e pushimit vjetor do të përcaktohet në bazë të përvojës së punës dhe me këtë rast çdo dy (2) vjet përvojë pune e rrisin pushimin vjetor për një (1) ditë pune. 4. Nëpunësit civilë nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për pushim vjetor. Pushimi vjetor merret brenda vitit kalendarik që fitohet. 5. Nëpunësi civil mund t'i bartë në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) ditë pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor duhet të shfrytëzohen brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik. 6. Anulimi ose shkurtimi i pushimit vjetor nuk mund të përdoret si masë disiplinore. 7. Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar.

- **Nenit 83:** "Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të pezullohet, ndërpritet dhe të përfundojë sipas kushteve të parapara me këtë ligj",

- **Nenit 84:** Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil ndërpritet për shkak të paaftësisë për ushtrimin e detyrës në shërbimin civil, e cila është dëshmuar dhe certifikuar nga komisioni mjekësor. Marrëdhënia e punës 25 ndërpritet për shkak të paaftësisë vetëm në rast kur shkalla e paaftësisë nuk e mundëson transferimin në ndonjë pozitë tjetër në shërbimin civil"

- **Nenit 85:** "Ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, me vendim të njëanshëm bëhet kur institucioni ose nëpunësi civil merr iniciativë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. 2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil ndërpritet me vendim të njëanshëm në rast të: 2.1. dorëheqjes dhe shkarkimit nga shërbimi civil për arsytet e parapara me këtë ligj.

- **Nenit 90:** "1 Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve dhe fakteve, pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucioni. 2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me: 2.1. arritjen e moshës së pensionimit; 2.2. paaftësinë e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore; 2.3. përfundimin e afatit për punësimet me afat të caktuar sipas këtij ligji; 2.4. dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër; 2.5. vdekjen e nëpunësit civil,

Nenit 91: Pensionimi 1. Moshë e pensionimit e nëpunësve civilë, si të gjinisë mashkullore ashtu edhe të asaj femërore, është gjashtëdhjetepesë (65) vjeç. 27 2. Nëpunësi civil informohet për përfundimin e punësimit, gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës.

Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e aktit të brendshëm të SKQZ-së, gjegjësisht Udhëzimit Administrativ (ZQZ) - NR. 01/ 2018 Për Pushimet e Stafit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me theks të veçantë nenin 6 më të cilin përcaktohet se: Sekretariati, ne fillim të vitit kalendarik përgatit planin orientues të shfrytëzimit të pushimeve vjetore. 2. Plani orientues hartohet duke marrë parasysh kërkesat e punonjësve të Sekretariatit dhe nevojat e njësisë së Institucionit. 3. Pushimi vjetor lejohet sipas procedurave të parapara në nenin 7 të këtij Udhëzimi. 4. Punonjësit e sekretariatit, nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për pushim vjetor, ndërsa pushimi shfrytëzohet brenda vitit kalendarik që fitohet. 5. Përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, Punonjësit e sekretariatit, mund t'i barte në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) dite pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor duhet të shfrytëzohen brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm kalendarik. 6. Në rastet kur ka zgjedhje, punonjësit e Sekretariatit, mund të bartin pushimin e pashfrytëzuar vjetor me marrëveshje me udhëheqësin e tij mund të barte pushimin për vitin tjetër kalendarik. 7. Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar. 8. Në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Institucion, punonjësit e Sekretariatit kompensohen me pagese të kalkuluar pre ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor. Në rastin e kundërt, nëse ditët e pushimit vjetor janë shfrytëzuar para kohës së fitimit të drejtës për pushim, atëherë nga paga e fundit behën ndalesat e kalkuluar për ditët e pa fituara. 9. Punonjësit e Sekretariatit, mund të kërkojnë pushim vjetor në çfarëdo kohë gjati vitit, pas miratimit të kërkesës nga udhëheqësi i tij. Mosmiratimi i kërkesës duhet të arsyetohet. 10. Për punonjësit e Sekretariatit me orar të shkurtuar, zbatohen të njëjtat dispozita, sipas këtij neni, në mënyrë proporcionale me orët e punës. Ndërsa neni 7 i këtij Udhëzimi ka vendosur rregulla procedurale lidhur me shfrytëzimin e pushimit vjetor ku thuhet se: Punonjësit e Sekretariatit, paraqesin kërkesë (shtojca nr. 1 e këtij Udhëzimi) të udhëheqësi i tyre, se paku tri (3) dite pune para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor, në pajtim me paragrafin 1,

të nenit 6, të këtij Udhëzimi. Kërkesa e miratuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punonjësit, i dërgohet menaxherit të personelit, për të përfshirë në dosjen personale të punonjës.

Në kuptim të kuadrit ligjor dhe bazuar në dëshmitë materiale të kësaj çështje, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së ankuesja me rastin e pensionimit ka të pa shfrytëzuar pushim vjetor gjithsej 67 ditë dhe atë 38 ditë për vitin 2022 dhe 29 ditë për vitin 2023, e të cilën pushim e njëjta sipas provave të lëndës nuk ka mundur ta shfrytëzoj në periudhën përkatëse, pasi që e njëjta disa herë radhazi është dashur të ndërpresë pushimet vjetore për shkak të angazhimeve në punë si dhe për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovica e Veriut, Leposavic, Zubin Potok dhe Zveçan të planifikuara të mbahen me datë 18.12.2022, por të shtyra të mbahen me datë 23.04.2023), fakte këto të dëshmuara sipas komunikimeve elektronike të ankueses më udhëheqësin e saj të drejtpërdrejt si dhe Vendimeve: 01/1369-2022 të datës 15.11.2022 dhe 02/236-2023 të datës 06.03.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së.

Andaj, duke qenë së organi i punësimit me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetoj faktin së ankuesja ishte njoftuar në pajtim me nenin 91 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil, ku thuhet se: *Nëpunësi civil informohet për përfundimin e punësimit, gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës, rrejdhimisht sipas shkresave të lëndës nuk është provuar fakti së ankuesja ishte njoftuar nga njësia përgjegjëse gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për arsye të arritjes së moshës së pensionimit si dhe përkitazi më drejtat dhe detyrimet ligjore që burojnë nga kjo gjendje juridike, por e njëjta është njoftuar me datë 05.06.2023, kur ka pranuar vendimin me numër protokollit 02/707-2023 të datës 05.06.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së. Kështu që, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit mos informimi me kohë i ankueses siç përcaktohet me nenin 91 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil, ka ndikuar që e njëjta të mos i realizoj disa nga të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës siç është edhe e drejta e shfrytëzimit të pushimit vjetor, ashtu që mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson së ankuesja gëzon të drejtën e kompensimit të ditëve të pa shfrytëzuar të pushimit vjetor, duke aplikuar në mënyrë analoge dispozitat e nenit 6 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (ZQZ) - NR. 01/ 2018 Për Pushimet e Stafit të Sekretariatit të Komisionit të Qendror të Zgjedhjeve, andaj edhe pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.*

Kolegji i Këshillit në mbështetje të gjendjes së fakteve si më lartë si dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca..*” si dhe nenin 11 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin thuhet se: *1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure...*” konstaton së vendimet e kundërshtuar më ankesës janë nxjerrë mbi bazën e vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave materiale, andaj, Kolegji sipas nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1279/2023

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankueses Avokat
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror Zgjedhor, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.